LIGJ
Nr. 77/2014

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 039, DATË 22.12.2008, "PËR NDIHMËN JURIDIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën juridike", të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 2, fjalia e parë riformulohet si më poshtë:
"Ushtrimi efektiv i së drejtës për t'iu drejtuar organeve të administratës publike dhe/ose të sistemit të drejtësisë, nëpërmjet dhënies së ndihmës juridike nga shteti për individët, mbështetet në parimet:".

Neni 2

Në nenin 10, pas shkronjës "j" shtohet shkronja "k" me këtë përmbajtje:
"k) i propozon Dhomës Kombëtare të Avokatisë, në rast të shkeljes së dispozitave të këtij ligji, fillimin e procedimit disiplinor për marrjen e masave të pezullimit ose heqjes së lejes së ushtrimit të profesionit të avokatit, në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë.".

Neni 3

Në nenin 11, titulli ndryshohet si më poshtë:
"Ndihma juridike dhe llojet e saj".

Neni 4

Pas nenit 11 shtohet neni 11/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 11/1
Subjektet përfitues të ndihmës juridike

Subjektet përfitues të ndihmës juridike janë:
a) shtetasit shqiptarë me vendbanim në territorin e Republikës së Shqipërisë;
b) shtetasit e huaj që e përfitojnë atë mbi bazën e parimit të reciprocitetit;
c) personat pa shtetësi, të pajisur me leje qëndrimi, sipas legjislacionit në fuqi;
ç) personat me shtetësi të huaj ose personat pa shtetësi, që kërkojnë të pajisjen me leje qëndrimi, aplikojnë për azil ose që janë në proces ankimi të vendimeve administrative dhe/ose gjyqësore për refuzimin e lejes së qëndrimit ose aplikimit për azil.".

Neni 5

Në nenin 12/1, pika 1 riformulohet si më poshtë:
"1. Klinikat ligjore vendore kanë si qëllim të veprimtarisë së tyre ofrimin e ndihmës juridike parësore.".

Neni 6

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 13
Kriteret për përfitimin e ndihmës juridike

1. Të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e kanë personat, të cilët:

a) kërkojnë të mbrohen me avokat në procesin penal në të gjitha fazat e tij dhe, për shkak të pamundësive financiare, nuk kanë mundur të zgjedhin një avokat ose kanë mbetur pa të;

b) kanë nevojë për ndihmë juridike në çështjet civile ose administrative, por nuk kanë mjete të mjaftueshme për ta paguar këtë ndihmë juridike ose çështjet janë tepër komplekse, nga ana e përmbajtjes dhe e procedurës;

c) kanë nevojë të mbrojnë të drejtat e tyre, nëpërmjet paraqitjes së kërkesë-padisë, por nuk kanë mjete të mjaftueshme për të paguar taksën mbi aktet, si dhe shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore. Në këtë rast, që personi ta përfitojë ndihmën juridike, duhet të vërtetojë se:

i) përfshihet në programet e mbrojtjes sociale ose plotëson kushtet për t'u përfshirë në to; ose

ii) është viktimë e dhunës në familje ose viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, për çështjet gjyqësore që lidhen me to.

2. Të miturit, për të cilët mbrojtja në procedimin penal dhe në gjykim është e detyrueshme me ligj, si dhe të miturit e dëmtuar nga vepra penale kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë juridike në të gjitha fazat e procedimit, të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

3. Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike vlerëson plotësimin e kritereve të përfitimit të ndihmës juridike, të tilla si të ardhurat financiare të pamjaftueshme të personit dhe të personave që janë në ngarkim të tij/saj, përbërja familjare, statusi shoqëror, përfshirja në programet e mbrojtjes sociale ose plotësimi i kushteve për t'u përfshirë në to dhe çdo rrethanë tjetër që e vendos personin në kushte pamundësie, për të siguruar privatisht ndihmë juridike.

4. Ministri i Drejtësisë, me propozim të Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike, nxjerr udhëzim të veçantë për detajimin e kritereve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

Tabela për kategorizimin e përqindjeve të përfitimit të ndihmës juridike sipas numrit të anëtarëve që personi ka në përbërjen e tij/saj familjare dhe të ardhurave mujore mesatare të familjes së tij, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 7

Në nenin 14, pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

"2/1. Subjektet, të cilat, sipas këtij ligji, kanë detyrimin dhe nuk vërtetojnë pamundësinë financiare si kriter për përfitimin e ndihmës juridike, janë të detyruara të kthejnë të gjitha shpenzimet e kryera për ofrimin e kësaj ndihme, brenda afatit të caktuar nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike.".

Neni 8

Në nenin 15, pika 1, shkronja "dh" ndryshohet si më poshtë:

"dh) plotësimin e kritereve të parashikuara në nenin 13;".

Neni 9

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 16

Paraqitja e kërkesës dhe dokumentacionit për përfitimin e ndihmës juridike

1. Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike, në formën e përfaqësimit në gjykatë, për një çështje civile ose administrative, duhet të paraqitet personalisht nga kërkuesi apo përfaqësuesi i tij, i autorizuar me prokurë, pranë Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike.

2. Personat, të cilët kërkojnë të përfitojnë nga ndihma juridike, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të vërtetojnë se përmbushin një ose disa prej kritereve të përcaktuara në këtë ligj, duke i bashkëngjitur kërkesës për dhënien e ndihmës juridike dokumentacionin përkatës.

3. Personat, të cilët deklarojnë se përfshihen në programet e mbrojtjes shoqërore dhe të miturit përjashtohen nga detyrimi për paraqitjen e dokumentacionit shoqërues, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 2 të këtij neni. Në këtë rast, Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm.

4. Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike, në formën e përjashtimit nga pagimi i taksës mbi aktet, si dhe shpenzimeve të nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore, duhet të paraqitet personalisht nga kërkuesi apo përfaqësuesi i tij, i autorizuar me prokurë. Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike në format e tjera, të parashikuara në nenin 12, të këtij ligji, nuk i nënshtrohet asnjë forme. Ajo mund të paraqitet edhe verbalisht te personi i autorizuar për dhënien e ndihmës juridike apo për caktimin e ofruesit të kësaj ndihme.

5. Në rastet kur ofrimi i ndihmës juridike paraqet urgjencë, vërtetimi i plotësimit të kritereve mund të bëhet në një moment të mëvonshëm dhe ndihma juridike jepet menjëherë. Personi që përfiton ndihmë juridike, sipas kësaj dispozite, ka detyrimet e parashikuara në nenin 16/1 dhe në nenin 14 të ligjit. Ngarkohet Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike që të përcaktojë rast pas rasti kushtet e urgjencës.

6. Formulari i kërkesës, dokumentet shoqëruese dhe rregullat e hollësishme, në zbatim të pikave të mësipërme të kësaj dispozite, përcaktohen nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike.".

Neni 10

Pas nenit 16 shtohet neni 16/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 16/1

Bashkëpunimi i përfituesve të ndihmës juridike dhe institucioneve shtetërore me Komisionin Shtetëror të Ndihmës Juridike

1. Personi, i cili përfiton ndihmë juridike, ka detyrimin të bashkëpunojë me Komisionin Shtetëror për Ndihmën Juridike, të japë informacion të vërtetë, për të cilin është kërkuar ndihma juridike, si dhe të sigurojë në kohë çdo informacion për rrethanat dhe kushtet, që kanë ndryshuar shkakun e dhënies së ndihmës.

2. Moszbatimi i pikës 6, të këtij neni, nga personi, që përfiton ndihmën juridike për çështjet civile ose administrative, përbën shkak për ndërprerjen e menjëhershme të përfitimit të kësaj ndihme juridike.".

Neni 11

Në nenin 18, pika 2, në fund të shkronjës "b" shtohen fjalët "në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë".

Neni 12

Në nenin 20, pas pikës 3, shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

"4. Avokati i caktuar për dhënien e ndihmës juridike ka detyrimin të pranojë detyrën dhe të mos heqë dorë prej saj, duke mos cenuar në asnjë rast të drejtën e të përfaqësuarit për t'u mbrojtur, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga pika 2, e nenit 18. Në rastet kur avokati i caktuar për dhënien e ndihmës juridike paraqet kërkesë për dorëheqje, sipas nenit 18, pika 2, shkronja "b", kërkesa e tij duhet të jetë e motivuar dhe e bazuar në fakte dhe/ose prova.

5. Dorëheqja e avokatit të caktuar nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike, sipas pikës 4, të këtij neni, nuk ka efekt derisa pala të ndihmohet me një mbrojtës të ri dhe të ketë mbaruar afati që mund t'i jetë dhënë mbrojtësit zëvendësues për t'u njohur me aktet dhe provat.".

Neni 13

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 6, pika 4, të këtij ligji.

Ngarkohet Ministri i Drejtësisë që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë udhëzimin e parashikuar në nenin 6, pika 4, të këtij ligji.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 10.7.2014

Shpallur me dekretin nr. 8653, datë 9.7.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani